

Ftese per Oferte

**Thirrje për oferte me objekt:
Rehabilitim dhe mobilim i Qendrës Komunitare “Te Qendrojme se bashku”
Kombinat, Bashkia Tirane, Nr. ALB/24/305”**

Informacion i përgjithshëm mbi organizatën

Terre des hommes (Tdh) është organizata lider zvicerane për ndihmën ndaj fëmijëve, e themeluar në vitin 1960. Tdh operon në Shqipëri që nga viti 1993 në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve, migrimit dhe drejtësisë për të miturit. Fusha e ekspertizës së Terre des hommes varion nga ndërhyrjet psiko-sociale te fuqizimi i institucioneve qeveritare dhe aktorëve kryesorë të nivelit vendor, rajonal dhe kombëtar dhe forcimi i mbrojtjes së fëmijëve, sistemit të drejtësisë për të miturit dhe sistemit të përfshirjes sociale për migrantët në Shqipëri

Informacion i përgjithshme mbi projektin

Projekti “Parandalimi dhe riintegrimi i sigurt: Qasja holistike dhe qëndrueshmëria ndaj ekstremizmit të dhunshëm”, i financuar nga Fondi Global i Angazhimit dhe Qëndrueshmërisë së Komunitetit (GCERF) zbatohet nga Terre des hommes Shqipëri në partneritet me Qendrën Koordinuese për Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm (CVE Center).

Gjatë periudhës 2023-2024, Terre des Hommes do të kontribuojë në krijimin e një modeli të ri shërbimesh që integrojnë programe të specializuara, kapacitete dhe burime për RRR dhe PVE në Bashkinë Tiranë, duke mbështetur pilotimin e qendre komunitare brenda Bashkise Tirane.

Mandati i qendrës do të përfshijë shërbime për riintegrim, parandalim dhe emergjencë për të kthyerit dhe grupet në rrezik. Ajo do të ketë kapacitete të specializuara, burime, programe dhe modele pune të dedikuara për të riintegruar në shoqëri individët e ekspozuar ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm, si dhe për të parandaluar ekstremizmin dhe radikalizimin e individëve në rrezik, duke siguruar një përgjigje më efektive, cilësore dhe të koordinuar ndaj nevojave të të kthyerve dhe individëve në rrezik, veçanërisht në rritjen e numrit të rasteve në Bashkinë Tiranë.

Projekti konsiston në zhvillimin e një hapësire brenda qendrës komunitare “Të qëndrojmë së bashku”, e cila do të përshtatet në funksion të zhvillimit të aktiviteteve psikosociale, psikologjike, mbështetjes arsimore dhe rekreative. Hapësira e vënë në dispozicion, në bazë të Marrëveshjes së Donacionit të lidhur mes palëve Bashkia Tiranë dhe “Terre des Hommes” do të përshtatet sipas nevojave dhe kërkesave që nevojiten.

1. Përshkrimi i punës

Terre des hommes Misioni në Shqipëri, kërkon një kontraktor të regjistruar ligjërisht për të kryer punime rehabilituese dhe mobiluese ne Qendrën Komunitare “Te Qendrojme se bashku” Kombinat, Bashkia Tirane.

2. Subjektet më të drejte aplikimi

Të gjitha kompanitë e regjistruara dhe të licensuara me objekt aktiviteti në përputhje me objektin e kësaj thirrje dhe që janë në përputhje me paragrafin 1 kanë të drejtë të shprehin interesin e tyre për të marrë pjesë në këtë thirrje për tender. Palët e interesuara duhet të jenë në gjendje të ofrojnë një faturë të fiskalizuar në zbatim të Ligjin Nr. 87/2019, datë 18.12.2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit" në përputhje me situacionin e punimeve të kryera prej tyre.

Kompanitë e interesuara kanë mundësinë të caktojnë një takim për të vizituar vendin dhe për të shqyrtuar punën e nevojshme për t'u kryer, për të lehtësuar përgatitjen e ofertës së tyre financiare.

3. Shprehje e interesit

Te gjitha kompanitë e interesuara për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi janë të lutura që të dergojnë ofertat e tyre ekonomike dhe teknike në adresën : alb.application@tdh.org ose të vendoset në zarf të mbyllur, me numrin e tenderit "ALB/24/305" të shënuar në pjesën lart-djathas dhe të dërgohet në: Zyrat e Terre des hommes në Tiranë, Shqipëri: Adresa: Rruga "Skënderbej", Nd. 6 H. 2, Ap. 17 & 18, Tirana, Albania, para datës 17.12.2024, ora 12:00.

Për të vizituar vendin e kryerjes së punimeve duhet që kërkesën t'a dergojnë në te njejten adresë elektronike, deri më 13.12.2024.

Që një ofertë të jetë e vlefshme, ajo duhet të përmbajë minimalisht këto informacione:

- 1) Certifikatë e regjistrimit të biznesit.
- 2) License të ushtrimit të aktivitetit.
- 3) Informacion për kompaninë duke përfshirë punët paraprake të kompanisë (CV e kompanisë)
- 4) Çmimin final duke përfshirë të gjitha kostot (materialet, puna, paisjet)
- 5) Afatin e realizimit të punimeve.
- 6) Kushtet e pagesës

4. Kriteret e përzgjedhjes:

Propozimet e marra do të vlerësohen nga një komision i brendshëm i cili do të vendosë për përzgjedhjen e kompanisë fituese bazuar në kriteret e mëposhtme në rendin e listuar:



- 1) Kostoja totale (Oferta financiare)
- 2) Specializimi në lidhje me detyrat
- 3) Afati kohor i dorëzimit të punimeve
- 4) Kushtet e pagesës

5. Angazhimi

Kushtet e bashkëpunimit me kontraktorin e përzgjedhur do të rregullohen me anë të një marrëveshjeje kuadër që duhet të nënshkruhet përpara se të kryhet çdo punim dhe/ose transaksion financiar.

Para nënshkrimit të kontratës kompania kontraktuese e përzgjedhur do t'i nënshtrohet procesit të vetingut, për t'u siguruar që nuk është e lidhur në asnjë formë të aktivitetit kriminal.

Kontraktori i përzgjedhur duhet të nënshkruajë politikat e brendshme të Tdh si mëposhtë:

- 1) Politikën Anti-Mashtrim/Korrupsion dhe konfliktit të interesit
- 2) Praktikrat e mira të biznesit
- 3) Kodin Global të Sjelljes
- 4) Politikat për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual (PSEA),

6. Dorëzimi i punëve

Të gjitha punimet duhet të dorëzohen plotësisht para [30.12.2024]